



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SELENICË

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT, MJEDISIT DHE INVESTIMEVE

Nr. 2546/1 Prot

Selenicë, më 23.12.2024

Lënda: Njoftim për kryerje punimesh.

DREJTORISË SË UJITJES DHE KULLIMIT FIER

Lagja Afrim i ri, RR.Fier Seman

Për dijeni: Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit
Bashkia Selenicë

Në zbatim të Vkm 408 datë 13/05/2015 "Për miratimin e zhvillimit të territorit" i ndryshuar me vkm nr 377/ date 16.06. 2024 kërkesës me nr 2546 date 11.12.2024 per kryerje punimesh 'per mbrojtje nga lumi shushice ne Drashovice Vlore'. Ju njoftojmë se lejohet të kryeni punime, për të cilat nuk kërkohet pajisja me leje ndërtimi.

Referuar dokumentacionit dërguar nga ju (preventivi, relacioni, projekt), rezulton se projekti do të zhvillohet ne zone te mbrojtur PK 'Lumi Vjose', Shpallur me VKM-ne nr. 155, date 13.03.2023, "Per shpalljen e ekosistemit natyror te lumit Vjosa, Park Kombetar. Kategoria II", pjesa me e madhe ne nenzone qendrore (ZQ) dhe pjesa tjeter ne nenzone e perdorimit tradicional dhe te qendrueshem (ZPT/Q).

Gjate zbatimit te punimeve te kihet ne reference Ligji nr. 21/2024 'Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr. 81/2017 'Per zonat e mbrojtura', neni 16 pika 2, nenit 33, nenit 48 dhe 49, si dhe VKM-se nr. 155, date 13.03.2023.

Gjithashtu ju njoftojmë se ju mund të kryeni punime vetëm për ato që keni kërkuar në kërkesën tuaj. Kryerja e punimeve të tjera, jashtë atyre të deklaruar, pa u pajisur me lejet përkatëse sipas ligjeve në fuqi, ju vë në përgjegjësi para ligjit.

KRYETARI

Nertil Bellaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E UJITJES DHE KULLIMIT FIER

Nr. 304/Prot
14

KONTRATË

REF - Nr. UP. 304/5 Prot., datë _____

REF-21927-09-27-2024

Lidhur sot më datë 26. 11. 2024, midis palëve:

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier, me NIPT K53001402U me adresë: Rruga Fier-Seman, 50 m nga shinat e trenit, Përfaqësuar nga titullari Z. Theodor Stefa dhe

Kontraktori: OE B93 II shpk me NIPT L522090500 me adresë: Rruga "Margarita Tutulani", pallati "Kaso", Apartamenti nr.76 TIRANE Përfaqësuar nga administratori Z. Ardit Liçaj.

-Baza Ligjore-

Kontrata hartohet në bazë të dispozitave ligjore të parashikuara Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimeve Publike, Ligjin Nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë

Neni 1

Objekti i Kontratës

Kjo kontratë ka si objekt realizimin e punimeve "Mbrotje nga lumi Shushicë në Drashovicë, Vlorë"



Objektit i kontratës do të realizohet nga Kontraktori B93 II shpk i cili pranon t'a realizojë atë sipas ofertës së ofruar prej tij dhe pranuar si fituese në procedurën përkatëse të prokurimit publik nga Autoriteti Kontraktor – Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier në përputhje me dokumentet e tenderit.

Neni 2

Çmimi i Kontratës

2.1 Vlera totale e kësaj kontrate është:

- Pa TVSH 38 247 720 (*tridhjetë e tetë milion e dyqind e dyzet e shtatë mijë e shtatëqind e njëzet*)

- Me TVSH 45 897 264 (*dyzet e pesë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër*)

Neni 3

Formimi i Kontratës

- 3.1 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.
- 3.2 Pjesët përbërëse të kësaj kontrate, krahas parashikimeve të bëra në këtë dokument, të cilave do t'u referohen palët gjatë zbatimit të saj, janë:
- ✓ Formulari i Ofertës dhe Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit;
 - ✓ Formulari i Specifikimeve Teknike;
 - ✓ Grafiku i realizimit të punimeve;
 - ✓ Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit;
 - ✓ Kriteret e veçanta të kualifikimit;
 - ✓ Formulari i Njoftimit të Fituesit;
 - ✓ Kushtet e përgjithshme të kontratës, pjesë përbërëse e DT;
 - ✓ Kushtet e veçanta të kontratës, pjesë përbërëse e e DT;
 - ✓ Sigurimi i Kontratës;
 - ✓ Projekti i dorëzuar nga Kontraktori dhe miratuar nga Autoritetit Kontraktor;
 - ✓ Preventivi i zbatimit, i përlllogaritur nga Projekti i dorëzuar nga Kontraktori dhe miratuar nga Autoritetit Kontraktor.
- 3.3 Të gjitha këto dokumente janë pjesë integrale e kësaj Kontrate. Në rast se ka paqartësi midis Kushtet e përgjithshme të kësaj kontrate dhe Kushteve te veçanta, atëherë kjo kontratë do të interpretohet duke u bazuar ne kushtet e veçanta të saj, parashikuara në pikën 3.2 të këtij neni.



Neni 4

Lloji i kontratës

- 4.1 Kjo Kontratë është "Kontratë me matje".

Neni 5

Sigurimi i kontratës

- 5.1 Sigurimi i kontrates në vlerën prej 4 589 729,4 Lekë do të ofrohet nga Kontraktori për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas Kontratës, garanci e cila do të jetë e vlefshme deri në zbatimin dhe përmbushjen e plotë të kushteve të saj.
- 5.2 Shuma e sigurimit të Kontratës duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor ose te garantohet nga nje kompani e sigurimeve si kompesim për çdo humbje të rezultuar nga deshtimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas Kontratës.
- 5.3 Sigurimi i kontratës do të mbulojë afatin deri në 30 ditë pas përfundimit të kontratës. Megjithatë, 5 (pesë) përqind e depozitës do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqëshme të kontratës.

Neni 6

Afati i realizimit të kontratës

- 6.1 Afati i realizimit të Kontratës është 2 muaj ga hyrja ne fuqi e kontratës.
- 6.2 Realizimi para kohe është i pranueshëm.
- 6.3 Autoriteti Kontraktor do të shtyjë afatin për realizimin e Kontratës nga Kontraktori, nëse: gjatë zbatimit të saj, Kontraktori është apo ishte në pamundësi realizimi, për shkaqe të pengesave nga Autoritetit Kontraktor për arsye plotesisht të justifikueshme prej këtij të fundit, ose për shkaqe natyrore të kushteve meteorologjike, apo kushte teknike të cilat e bëjnë të pamundur realizimin e punimeve;
- ose për shkaqe madhore që janë jashtë mundësive të zgjidhjes së Kontraktorit. Afati per realizimin e kontrates do të shtyhet për aq ditë sa zgjat zgjidhja e problematikës që nuk varet nga Kontraktori. Këto shkaqe duhen njoftuar dhe dokumentuar nga Kontraktori dhe/ose Autoriteti Kontraktor, si dhe Mbikëqyrësi i punimeve. Afati i realizimit të kontratës do të shtyhet me aq ditë sa kanë qenë ditët me kushte të pamundura për të punuar, duke filluar nga data kur njoftimi dhe dokumentacioni për këtë shkak është paraqitur në rrugë zyrtare (me shkresë) pranë Protokollit të Autoritetit Kontraktor ose nepermjet komunikimeve elektronike zyrtare tek Drejtuesi i Projektit.



Neni 7

Hyrja në fuqi e kontratës

- 7.1 Kontrata hyn në fuqi (quhet Datë Efektive e Kontratës), kur plotesohen të gjitha kushtet e mëposhtme:
- Me nënshkrimin e saj nga te dyja palët.
 - Me dorëzimin e Sigurimit të Kontratës nga ana e Kontraktorit.
 - Me dorëzimin e Sigurimit të Paradhënies nga ana e Kontraktorit, nëse pagesa e paradhënies do të kërkohet nga ky i fundit.
 - Me dorëzimin e Sheshit të Ndërtimit.
- 7.2 Në rast se këto kushte përmbushen në data të ndryshme, data e përmbushjes së kushtit të fundit do të jetë edhe data e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.

Neni 8

Sheshi i Ndërtimit/Kantieri i Punimeve dhe Grafiku i Punimeve

- 8.1 Kantieri i Punimeve do të jetë sipas përshkrimeve të Specifikimeve Teknike, Shtojca 5 e DST.

Neni 9

Mbikëqyrësi i Punimeve

- 9.1 Mbikëqyrësi i Punimeve do të njoftohet në kohën e lidhjes së kontratës për këtë qëllim.
- 9.2 “Mbikëqyrësi i Punimeve” do të ushtrojë:
- Të gjithë të drejtat dhe detyrimet që Ligji Nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të publikuara në zbatim të tij që parashikohen për Mbikëqyrësin e Punimeve si dhe,
 - Të gjithë të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë kontratë (sipas përcaktimeve të bëra për kontratën në nenin 3 të saj).
- 9.3 Ashtu siç parashikohet “Mbikëqyrësi i Punimeve” për materialet që do furnizohen nga kontraktori si dhe punimet të cilat do të kryhen, do të kërkojë nga ky i fundit dokumentacionin e mëposhtem:
- ✓ Certifikatë ose dokument që vërteton Origjinën e materialeve elektrike pjesë përbërëse të kontratës.
 - ✓ Dokument lidhur me Garancinë e materialeve pjesë përbërëse të Kontrates, leshuar nga Prodhuësi/Kontraktori.



- ✓ Certifikatë e inspektimit dhe testimit të materialeve pjesë perberese e kontrates, nese parashikohen ne specifikimet teknike leshuara nga institucione te autorizuar ose nga prodhuesi.
- 9.4 Në rast se Mbikëqyrësi i Punimeve do të ndryshohet, Autoriteti Kontraktor njofton menjëherë Kontraktorin.

Neni 10

Drejtuksi i Projektit për Autoritetin Kontraktor

10.1 Drejtuesi i Projektit është përgjegjës për:

- ✓ Administrimin e kontratës.
 - ✓ Përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës.
 - ✓ Përcjelljen e dokumentacionit të pagesës pranë DUK Fier
 - ✓ Hartimin dhe dergimin pranë DUK Fier të "Formularit të raportimit të zbatimit të kontratës", sipas Udhëzimeve në fuqi.
- 10.2 Drejtuesi i Projektit do të ushtrojë të gjithë detyrat e përmendura më sipër duke përjashtuar detyrat që i takojnë, sipas kësaj kontrate dhe legjislacionit në fuqi, Mbikëqyrësit të Punimeve dhe Kolaudatorit.
- 10.3 Drejtuesi i Projektit vë në dijeni Titullarin e Autoritetit Kontraktor për çdo rast e çështje dhe nuk mund t'i drejtohet Kontraktorit pa marrë më parë miratimin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

Neni 11

Detyrimet e Kontraktorit

- 11.1 Objekti i kontratës do të realizohet nga Kontraktori në përputhje të plotë me këtë kontratë, gjithë pjesët përbërëse të kësaj kontrate sipas nenit 3 dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 11.2 Objekti i kontratës do të realizohet në përputhje të plotë me Specifikimet Teknike.
- 11.3 Kontraktori nuk lejohet të kryejë punime me nënkontraktim.
- 11.4 Kontraktori do të kryejë punimet dhe do të jetë përgjegjës vetë për saktësinë e kryerjes së punimeve dhe të gjithë pjesëve përbërëse të objektit të kontratës.
- 11.5 Kontraktori është i detyruar të respektojë përcaktimet ligjore në lidhje me ndotjen e mjedisit.
- 11.6 Kontraktori është i detyruar të zëvendësojë përfaqësuesit e vet dhe punonjësit e tjerë të kantierit, kur kjo gjë kërkohet nga Mbikëqyrësi i Punimeve/Autoriteti Kontraktor. Mbikëqyrësi i Punimeve i drejtohet me shkrim Kontraktorit, duke i shpjeguar arsyet. Arsyet kryesore të propozimit për largim mund të jenë moszbatimi i standardeve dhe i rregullave teknike, mosbindja, paaftësia, arbitrariteti në zgjidhjen e problemeve teknike ose pakujdesi të rënda. Kontraktori duhet të marrë masa për të siguruar që punonjësi në fjalë të largohet nga kantieri i punimeve brenda 72 oreve dhe të mos ketë



më lidhje me zbatimin e kësaj kontrate. Për këto njoftime mes palëve, Kontraktori duhet të vërë në dijeni edhe Autoritetin Kontraktor nëpërmjet Drejtuesit të Projektit.

Neni 12

Kryerja dhe drejtimi teknik i punimeve

- 12.1 Kontraktori do të kryejë punimet ne perputhje te plote me kushtet teknike (K.T.Z.) te zbatimit te punimeve civile të Republikës së Shqipërisë. Kontraktori do t'i filloje dhe mbaroje punimet civile ne perputhje me specifikimet teknike, kodet dhe standartet e paraqitura ne dokumentat e tenderit, me kushtet teknike te zbatimit.
- 12.2 Kodet dhe standartet qe do te zbatohen, do te jene ato te shprehura ne dokumentat e tenderit. Nese gjate ekzekutimit te kontrates, ka ndryshime ne zbatimin e kodeve ose standarteve, keto ndryshime do te zbatohen vetem pasi te jene aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.
- 12.3 Drejtimi teknik i punimeve ne kantier do te behet nga Drejtori Teknik. Funksionet e Drejtorit Teknik do te ushtrohen nga Drejtuesi Teknik i Kontraktorit.
- 12.4 Drejtori Teknik është personi pergjegjes nga ana e Kontraktorit per drejtimin teknik dhe zbatimin e punimeve ne kantier deri ne perfundimin e tyre, si dhe është perfaqesuesi i Kontraktorit ne te gjitha kontaktet me perfaqesuesit e Autoritetit Kontraktor.
- 12.5 Kontraktori është i detyruar te caktojë Drejtorin Teknik.
- 12.6 Detyrat e Drejtorit Teknik te punimeve jane si me poshte:
- a) Siguron drejtimin e kantierit;
 - b) Është pergjegjes per zbatimin e perpikte te specifikimeve teknike te kontrates, sipas vizatimeve, pershkrimit teknik e ndryshimeve te miratuara, ne perputhje me kerkesat e kushteve teknike te zbatimit, ne fuqi.
 - c) Te jete i pranishem dhe te perfaqesoje Kontraktorin ne te gjitha kontaktet, takimet zyrtare apo mbledhjet qe Autoriteti Kontraktor zhvillon me Kontraktorin dhe Drejtorin e Teknik ne zgjidhjen e diskutimin e ceshtjeve teknike e profesionale qe lindin gjate zbatimit te punimeve;
 - d) Është pergjegjes per dokumentacionin teknik qe është i detyrueshem te mbahet ne objekt;
 - e) Mban korrespondencen zyrtare me Mbikqyresin e Punimeve;
 - f) Njofton Mbikqyresin e Punimeve, per pasaktesite, mosperputhjet, mungesat e te dhenave ne vizatimet, pershkrimet e specifikimet teknike. Sa here qe e gjykon te arsyeshme paraqet propozime tek Mbikqyresin e Punimeve dhe pret udhezimet;
 - g) Është pergjegjes per ecurine e zbatimit te punimeve konform plan organizimit dhe grafikut te punimeve;
 - h) Është i pranishem ne te gjitha fazat e realizimit te objektit: zbatimin e punimeve, dorëzimin dhe kolaudimin e objektit;



- i) Instrukton dhe riinstrukton te gjithë punonjesit cdo fillim muaji, ne perputhje me programin mujor te punes;
 - j) Sa here qe kerkohet nga Mbikqyresin e Punimeve ve ne dispozicion te tij, Librin e kantierit, dokumentacionin e kontabilitetit teknik e te furnizimit te objektit me materiale e produkte ndertimi;
 - k) Ben njoftime brenda kohes se duhur per inspektimin e punimeve te maskuara, per marrjen e kampioneve, kryerjen e provave, te analizave qe parashikohen ne rregullat teknike ose kerkohen shtese nga Mbikqyresi i Punimeve, paraqet fotografite, kasetat filmike dhe cdo dokument tjeter qe provon saktesine e produkteve e te punimeve;
 - l) Me Urdher te Mbikqyresit te Punimeve prish dhe riben me shpenzimet e Kontraktorit, brenda periudhes se korrigjimit te difekteve, punimet qe rezultojne me shkelje te kushteve teknike te zbatimit, standarteve e specifikimeve teknike, pershejton kryerjen e punimeve tej grafikut dhe kohes normale te punes;
 - m) Është i detyruar te mbaje ditarin e objektit, ku te perfshihen te gjitha punimet e kryera dhe urdherat e dhena per zbatimin e kontrates. Ky ditar ne çdo kohe do ti vihet ne dispozicion Mbikqyresit te Punimeve, Grupit te Kolaudimit dhe Autoritetit Kontraktor.
- 12.7 Ne rast se Kontraktori kerkon te ndryshoje Drejtorin Teknik, ai duhet qe te lajmeroje me pare Mbikqyresin e Punimeve, i cili ve menjehere ne dijeni Autoritetin Kontraktor.

Neni 13


Sigurimi teknik

- 13.1 Kontraktori është pergjegjes per sigurimin teknik te te gjitha veprimtarive ne kantier. Kontraktori është pergjegjes per hartimin, sipas normave ligjore ne fuqi, te librit te instruktimit per sigurimin teknik dhe mbrojtjen ne pune. Ky liber hapet menjehere me fillimin e punimeve, perbehet nga flete te numertuara dhe te vulosura nga Kontraktori, ne te cilin pasqyrohen procesverbalet e instruktimit, emrat e punonjesve te instruktuar, atyre te aksidentuar, mbledhjet per sigurimin dhe mbrojtjen ne pune, kontrollet, detyrat dhe masat e marra ne zbatim te tyre.

Neni 14

Ndryshime

- 14.1 Çdo ndryshim i kerkuar nga Mbikqyresi i Punimeve do te hartohen ne baze te nje propozimi dhe ne baze te llogarive perkatese te bera nga Kontraktori dhe Mbikqyresi i Punimeve, cdo ndryshim do te aprovet nga Autoriteti Kontraktor.
- 14.2 Çdo ndryshim i urdheruar nga Mbikqyresi i Punimeve dhe i aprovuar nga Autoriteti Kontraktor do te jete objekt i nje akti me shkrim te firmosur nga Mbikqyresi i Punimeve, Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori.



- 14.3 Kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të kontratës, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kësaj kontratës, që, në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.

Neni 15

Testimet dhe Inspektimet

- 15.1 Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga të gjitha pjesët perberese të kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet teresisht nga Kontraktori brenda çmimit të kontratës.
- 15.2 Autoriteti Kontraktor, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose përgatiten në vende të ndryshme nga ato të Kontraktorit, Kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto teste dhe inspektime.
- 15.3 Nëse gjatë testeve të mesipërme, konstatohet ndonjë problem në montim, material i demtuar ose pjesë të pajisjeve që nuk janë në përputhje me specifikimet, Kontraktori, do të marrë masa menjëherë për zgjidhjen e problemit. Nëse Autoritetin Kontraktor e kërkon pas zëvendësimit do të përsëritet testimi.
- 15.4 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë Kontraktorit të bëjë teste ose inspektime shtesë të parashikuara në kontratë, por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se të gjitha materialet dhe pajisjet që do të furnizohen prej tij dhe punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së Kontraktorit, Autoriteti Kontraktor do të bëjë dakort të ndryshojë grafikun.
- 15.5 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo material të furnizuar prej Kontraktorit dhe punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.
- 15.6 Ekzekutimi i testeve, nuk do të lirojë Kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.
- 15.7 Kontraktori garanton se materialet e furnizuara prej tij dhe të trupezuara me punët janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se trupezojnë permiresimet e fundit në materiale, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë.
- 15.8 Me përjashtim të ndonjë parashikimi në kontratë ose nga ligji, Kontraktori garanton se materialet e furnizuara prej tij nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i Kontraktorit, materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizoterojnë në Shqipëri.
- 15.9 Materialet dhe produktet e ndërtimit me standarde të detyrueshme që do të vendosen në objekt duhet të jenë të shoqëruar me certifikata cilësie, me rezultatet e provave dhe të analizave, që vërtetojnë ose vlerësojnë përputhshmerinë e tyre me standardet që referohen në pershkrimet dhe specifikimet teknike.



- 15.10: Materialet dhe produktet e ndertimit qe nuk pranohen nga Mbikqyresi i Punimeve, per shkak se nuk plotesojne kerkesat e specifikimeve teknike dhe te kontrates, nuk vendosen ne objekt.
- 15.11 Inspektimet dhe testimet para marrjes ne dorezim te objektit te kontrates do te perfshijne te gjitha testimet dhe inspektimet te parashikuara ne specifikimet teknike pjese perberese e kesaj kontrate.
- 15.12 Kontraktori duhet te siguroje dokumentacion fotografik apo video-regjistrues per castet me te rendesishme te zbatimit te punimeve, vecanerisht per ato qe behen te padukshme, qe mund te jene objekt mosmarveshjeje ne te ardhmen dhe ato qe pasqyrojne masa mbrojtese e te kontrollit te cilesise te materialeve dhe te punimeve etj. Kopje te mjaftueshme i dorezohen Mbikqyresit te Punimeve cdo jave.

Neni 16

Mbarimi dhe Marrja Persiper e Punimeve

- 16.1 Gjate zbatimit te punimeve te ndertimit, ne kantier hartohet e grumbullohet dokumentacioni teknik ne perputhje me legjislacionin fuqi.
- 16.2 Ne perfundim te punimeve Kontraktori paraqet nje deklarate, ne formen e njoftimit, per perfundimin e punimeve. Mbikqyresi i Punimeve dhe Kontraktori mbajne nje procesverbal ku percaktohet data e perfundimit te punimeve.
- 16.3 Mbikqyresi i Punimeve informon menjehere Autoritetin Kontraktor per daten e perfundimit te punimeve.
- 16.4 Kontraktori, bazuar ne dokumentacionin teknik (te sipercituar) te grumbulluar dhe perpunuar, ne ndjekjen dhe kontrollin e punimeve, harton deklaratën teknike per punimet e ndertimit, e cila nenshkruhet nga drejtuesit teknik dhe ligjor te Kontraktorit, si dhe nga Drejtori Teknik i punimeve ne kantier dhe se bashku me dokumentacionin e mesiperme i dorezohet Mbikqyresi i Punimeve dhe Autoritetit Kontraktor, jo me vone se 30 dite nga dita e perfundimit te punimeve.
- 16.5 Mbikqyresi i Punimeve, mbas verifikimeve, se bashku me miratimin e tij i paraqet dokumentacionin Autoritetit Kontraktor.
- 16.6 Nje kopje e dokumentacionit te miratuar nga Mbikqyresi i Punimeve i dergohet, nga ky i fundit, kolaudatorit/grupit te kolaudimit. Kolaudimi i objektit do te behet menjehere, por jo me shume se 20 dite nga paraqitja e kerkeses prane Autoritetit Kontraktor, ne perputhje me percaktimet e bera ne ligjin Nr. 8402, dt. 10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit" (te ndryshuar) dhe te akteve te tjera ligjore dhe nenligjore ne fuqi. Ne perfundim te kolaudimit hartohet procesverbali i kolaudimit, i cili firmoset nga kolaudatori/grupi i kolaudimit, Kontraktori dhe Mbikqyresi i Punimeve. Autoriteti Kontraktor ose Mbikqyresi i Punimeve i autorizuar prej Autoritetit Kontraktor ne perputhje me procesverbalin e kolaudimit do te leshoje Certifikaten e Marrjes ne dorezim te punimeve. Pas perfundimit te kolaudimit, Mbikqyresi i Punimeve, mbështetur ne kontrate dhe ne dokumentacionin tjetër, percakton vleren perfundimtare te objektit e cila i behet e



ditur Kontraktorit dhe i jepet per likuidim Autoritetit Kontraktor, i cili, vepron sipas parashikimeve te nenit 5 te kesaj kontrate.

- 16.7 Kontraktori është pergjegjes per drejtimin, mbajtjen ne gatihmeri, riparimin, mirembajtjen, ruajtjen e punimeve te ndertim-montimit te objektit dhe kantierit, deri ne nenshkrimin e procesverbalit te kolaudimit.
- 16.8 Objekti merret ne dorezim ne daten e nenshkrimit te procesverbalit te kolaudimit.
- 16.9 Kontraktori, jo me vone se 30 dite pas nenshkrimit te procesverbalit te kolaudimit, heq ndertimet e perkohshme dhe realizon punimet perfundimtare te sistemimit.
- 16.10 Dosja e perbashket teknike e objektit, pas kolaudimit te punimeve, arkivohet prane Autoritetit Kontraktor. Kjo dosje është dokument i rendesise se veçante dhe ruhet sipas afateve te caktuara me ligj.

Neni 17

Garancia Teknike e Punimeve

- 17.1 Periudha e garancise teknike te punimeve është 1(nje) vit nga data e marrjes ne dorezim te objektit te kontrates. Periudha e garancise fillon nga data e leshimit te Certifikates se Marrjes ne Dorezim te Punimeve.
- 17.2 Garancia teknike do te jete 5 (pese) % e vleres se kontrates dhe do t'i mbahet Kontraktorit nga çdo pagese, si garanci per cilesine e punimeve.
- 17.3 Gjate periudhes se garancise se punimeve Autoriteti Kontraktor ose Mbikqyresi i Punimeve i autorizuar nga Autoriteti Kontraktor ka per detyre te njoftoje Kontraktorin lidhur me cdo defekt para mbarimit te kesaj periudhe. Per eliminimin e defekteve lihet nje afat i cili saktësohet sipas cdo rasti konkret por, ne cdo rast, jo me shume se 20 dite.
- 17.4 Ne qofte se Kontraktori nuk korrighon defektet e konstatuara ne periudhen e garancise teknike, brenda afatit te percaktuar Autoriteti Kontraktor ose Mbikqyresi i Punimeve i autorizuar nga Autoriteti Kontraktor do te vleresoje koston e korrighimit te defektit dhe Kontraktori do te paguaje kete shume, se bashku me nje gjobe te veçante. Nese, me perfundimin e periudhes se garancise, Kontraktori nuk ka korrighuar defektet e konstatuara, Autoriteti kontraktor, me propozim te Mbikqyresi i Punimeve, i zbrit nga garancia, deri ne konfiskimin e krejt garancise se punimeve.
- 17.5 Me perfundimin e kesaj periudhe Kontraktori paraqet kerkesen e kthimit te vleres se garancise teknike te punimeve, e cila i është mbajtur nga Autoriteti Kontraktor. Ky i fundit cakton komisionin e marrjes ne dorezim te objektit, i cili, ne bashkepunim me Kontraktorin, Mbikqyresi i Punimeve, Kolaudatorin/Grupin e Kolaudimit, brenda 10 diteve, organizojne viziten ne terren ku kontrollohen realizimet e detyrave te lena, korrighimi i defekteve te lindura gjate periudhes se garancise teknike te punimeve. Ne perfundim te kontrollit hartohet akti perkates i marrjes perfundimisht ne dorezim te objektit. Akti është subjekt i miratimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 17.6 Per defektet qe jane konstatuar dhe nuk jane ndrequr gjate periudhes se garancise teknike te punimeve, llogaritet kostoja e ndreqjes e cila pasqyrohet ne aktin e marrjes



perfundimisht ne dorezim te vepres. Garancia teknike do te paguhet nga Autoriteti Kontraktor mbas perfundimit te periudhes se garancise teknike te punimeve dhe miratimit nga Autoriteti Kontraktor te aktit te marrjes ne dorezim te objektit, duke patur parasysh edhe ndalesat e aplikuar.

- 17.7 Miratimi i aktit te marrjes perfundimisht ne dorezim te objektit shenon perfundimin e te drejtave dhe detyrimeve reciproke te kontrates se siper marrjes dhe asaj te mbikqyrjes se punimeve nga Mbikqyresi i Punimeve.

Neni 18

Defektet e Pakorrigjuara

- 18.1 Nese Kontraktori nuk e ka korrigjuar nje defekt brenda kohes se specifikuar ne njoftimin per defektin nga Mbikqyresi i Punimeve, Mbikqyresi i Punimeve do te llogarise koston e korrigjimit te defektit dhe kjo shume do te mbahet nga çdo pagese qe i duhet bere Kontraktorit deri sa defekti te korrigjohet. Deshtimi per te korrigjuar defektin brenda nje afati te arsyeshem perben shkak per zgjidhje kontrate per arsye mospermbushje ne favor te Autoriteti Kontraktor.

Neni 19

Kostoja e Riparimeve

- 19.1 Dentimi i punimeve ose humbja e materialeve qe do te perdoren per punimet, nga dita e fillimit deri ne marrjen ne dorezim, si dhe gjate afatit te garancise se defekteve, do te mbulohet nga Kontraktori me shpenzimet e tij ne qofte se humbja ose dentimi jane shkaktuar nga gabimet e veprimeve te tij.
- 19.2 Riparimet qe dalin te nevojshme gjate kolaudimit te vepres, nese jane per shkak te mosplotesimit te kontrates ose te punes jocosore te Kontraktorit do te mbulohen nga ky i fundit me shpenzimet e tij.

Neni 20

Rreziket e Kontraktorit

- 20.1 Kontraktori, prej fillimit deri ne ditën e kolaudimit te punimeve, me shpenzimet e veta, mbulon, korrigjon dhe zhdemton çdo dem qe shkaktohet nga paafesia, neglizhenca, te metat ne zbatim, mungesa e masave mbrojtese dhe sinjalizuese e perfaqesuesve dhe punonjesve ne:
- Pronen e te treteve dhe ne mjedisin ne afersi.
 - Rrjetin e infrastruktures se zones, ne kantier e ne afersi.
 - Punimet e ndertimit, administrimin dhe perdorimin e makinerive, te paisjeve, materialeve dhe produkteve ne kantier.
 - Rrezikun e punonjesve të tij të ngarkuar për realizimin e punimeve objekt kontrate.



Neni 21

Menyra e pageses

- 21.1 Pagesa për punët e kryera do të bëhet bazuar në preventivat e punimeve, ofruar nga Kontraktori gjatë procesit të prokurimit.
- 21.2 Autoriteti Kontraktor do t'i ekzekutojë të gjitha pagesat në favor të Kontraktorit me transferte bankare, në llogarinë e kontraktorit të bashkelidhur çdo fature elektronike dhe situacionit përkatës, në llogarinë bankare, të mëposhtme:
- IBAN: AL 5920511021942811CLPRCLALLB "BANKA KOMBETARE TREGTARE „BKT Bank”**
- 21.3 Kontraktori ka të drejtë të marrë pagesa periodike gjatë progresit të zbatimit të kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa periodike për Punët do të bëhet brenda 30 ditëve kalendrike.
- Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.
- 21.4 Çdo pagesë pjesore dhe pagesa e mbetur përfundimtare, duhet të referohet detyrimisht preventivit të zbatimit të punimeve të ofruar nga Kontraktori, brenda 30 ditëve, me paraqitjen e dokumentave të mëposhtme:
- Per pagesat pjesore:
 - ✓ Komunikatën (deklarata) e kontraktorit për punimet e realizuara;
 - ✓ Situacioni pjesor për punimet e realizuara;
 - ✓ Miratimi i Mbikqyresit të Punimeve për punimet e realizuara që duhet të paguhet;
 - ✓ Fatura elektronike;
 - Per pagesën e mbetur përfundimtare:
 - ✓ Komunikatën (deklarata) e kontraktorit për punimet e realizuara;
 - ✓ Situacioni përfundimtar;
 - ✓ Miratimi i Mbikqyresit të Punimeve për vleftën që duhet të paguhet;
 - ✓ Fature elektronike;
 - ✓ Librezen e masave;
 - ✓ Ditari i punimeve;
 - ✓ Proces-verbalet e punimeve (nëse ka);
 - ✓ Libri i objektit;
 - ✓ Fotografimet e proceseve të punës;
 - ✓ Proces verbali i dorëzimit të punimeve dhe akt kolaudimi;
 - ✓ Certifikatën e Martjes në dorëzim të punimeve.
- Të gjithë dokumentacioni i cituar në këtë pikë, të paraqitet origjinal / kopje e njesuar me origjinalin e noterizuar.**
- 21.5 Sa më sipër dhe të tjera që nuk janë përmendur, do të kompletohen sipas Udhezimit të KM Nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit".
- 21.6 Monedha e pagesës do të jetë LEK.
- 21.7 Në rast se, për arsye objektive, kontrata prishet nga Autoriteti Kontraktor, Mbikqyresi i Punimeve do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së kryer duke zbritur pagesat e marra deri në ditën e lëshimit të certifikatës.



Neni 22

Dëmet e Likuidueshme per Vonesen ne Mbarimin e Punimeve

- 22.1 Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore:
- Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
 - Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
 - Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- 22.2 Pagimi i penaltetit nuk e çliron Kontraktuesin nga detyrimet kontraktuale.
- 22.3 Penalteti do të mbahet nga pagesa/pagesat.

Neni 23

Vonesa ne Berjen e Pageses

- 23.1 Shperblimi per demet e shkaktuara si rezultat i voneses ne pagese konsiston ne kamaten e arritur nga data e fillimit te voneses se debitorit (Autoriteti Kontraktor), ne monedhen zyrtare te vendit ku do te behet pagesa. Perqindja e kamates parashikohet me ligj. Ne fund te çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bërë llogaritja e tyre.
- 23.2 Kamata ligjore paguhet pa qene i detyruar kreditori (Kontraktori) te provoje ndonje dem. Nese kreditori (Kontraktori) provon se ka pesuar nje dem me te madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktor) duhet te paguaje pjesen e mbetur te demit.

Neni 24

Forca Madhore

- 24.1 Kontraktori nuk do të mbaje përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës, demet e likuiduara ose ndërprerjen për plotësimin nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas Kontrates, vijnë si rezultat i ndodhjes së Forces Madhore.
- 24.2 Nëse ndodh ndonjë situatë e Forces Madhore, Kontraktori duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktor.



Neni 25

Vonesa ne Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

- 25.1 Me perjashtim kur parashikohet ndryshe, Kontraktori duhet te filloje zbatimin e kontrates sipas Nenit 7.
- 25.2 Autoriteti Kontraktor do te jete dakord per nje zgjatje te afatit ne rastin e Forces Madhore.
- 25.3 Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakord për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakord me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori.

Neni 26

Negociatat dhe Amendamentet

- 26.1 Palet nuk do te negociojne ndryshime ose amendamente te asnje kushti te kontrates qe do te ndryshonte dukshem kushtet qe perbejne bazen e perzgjedhjes se Kontraktorit.
- 26.2 Asnje amendament ose variacion tjetër i kontrates nuk do te jete i vlefshem pa qene me shkrim, me date, i referohet shprehimisht kontrates dhe nenshkruhet nga nje perfaqesues i autorizuar i Kontraktorit dhe Autoriteti Kontraktor.
- 26.3 Çdo heqje dore nga te drejtat, pushtetet ose ndreqjet qe mund te behen nga palet sipas kontrates duhet te behet me shkrim, te kete date dhe te firmoset nga nje perfaqesues i autorizuar i pales qe ben kete doreheqje dhe duhet te specifikojë te drejten dhe masen ne te cilen ajo leshohet.

Neni 27

Nderprerja per Mosplotesim

- 27.1 Autoriteti Kontraktor mund te nderprese kontraten ne teresi ose pjeserisht nese:
 - a) Kontraktori deshton ne kryerjen e Puneve brenda periudhes se specifikuar ne kontrate ose brenda zgjatjes se dhene; ose,
 - b) Kontraktori deshton te zbateje ndonje detyrim tjetër te kontrates.
- 27.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktorit njoftim me shkrim per nderprejten per mosplotesim dhe t'i japi Kontraktorit 15 dite te ndreqe mosplotesimin me perjashtim kur nderprerja është bere per veprime te korruptuara ose te paligjshme, rast ne te cilen nderprerja do te jete e menjehershme.



- 27.3 Te gjitha materialet, ngritja e kantierit dhe punet e perfundura do te behen prone e Autoriteti Kontraktor nese kontrata nderpritet per mosplotesim te kushteve te saj.

Neni 28

Nderprerja per Shkak te Falimentimit

- 28.1 Autoriteti Kontraktor mund te nderprese kontraten ne çdo kohe nese Kontraktori falimenton ose behet i paafte te paguaje.
- 28.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktorit njoftim me shkrim per nderperjen.

Neni 29

Nderprerja per Shkak te Interesit Publik

- 29.1 Autoriteti Kontraktor mund te nderprese kontraten ne çdo kohe nese gjykon se ky veprim duhet ndermarre per t'i sherbyer sa me mire interesit publik.
- 29.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktorit lajmerim me shkrim per nderperjen.
- 29.3 Autoriteti Kontraktor duhet te paguaje Kontraktorin per te gjitha punet e pranuar dhe te kryera perpara nderperjes dhe duhet t'i paguaje Kontraktorit demet e shkaktuara per kryerjen e pjesshme te puneve. Ne llogaritjen e shumes se demeve, Kontraktori do te kerkohet te ndermarre te gjitha veprimet e nevojshme per te minimizuar demet.

Neni 30

Komunikimi

- 30.1 Komunikimi midis paleve do te behet vetem me shkrim. Të gjitha komunikimet me shkrim, të bëra sipas kësaj Kontrate, ose çdo komunikim tjetër në lidhje me këtë Kontratë, nga secila nga Palët, Palës tjetër i dërgohen me një nga mënyrat e mëposhtme:
- a) Dorëzim në dorë të komunikimit me shkrim; dhe/ose
 - b) me postë ose me shërbim korrieri; dhe/ose
 - c) poste elektronike
- 30.2 Njoftimi konsiderohet i marre vetem pasi dorezohet zyrtarisht sipas procedurave te mesiperme.



Neni 31

Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

- 31.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdherese, urdher ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa Kontraktori është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 32

Llogaritja e Afateve

- 32.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike. Dhe të gjitha referencat e muajve do të jenë muaj kalendarike.

Neni 33

Zgjidhja e mosmarreveshjeve

- 33.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori duhet të bëjnë çdo përpjekje për të zgjidhur në mënyrë paqësore nepermjet negociatave direkte, çdo mosmarreveshje ose konflikt që mund të lindë midis tyre ose lidhur me kontratën.
- 33.2 Në rast se palet nuk do të jenë në gjendje t'i zgjidhin mosmarreveshjet ose konfliktet në mënyrë mesipërme, atëherë secila palë mund t'ia referojë çështjen gjykatës sipas legjislativës në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 34

Perfaqësimi i Paleve

- 34.1 Personi që do të jetë përgjegjës në emër të Autoritetit Kontraktor DUK Fier për administrimin e kontratës dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës si Administrator Kontrate do të jetë, si vijon:
- Z./Znj.
 - cel:
 - e-mail:
- 34.2 Personi që do të jetë përgjegjës në emër të Kontraktorit për administrimin e kontratës dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës, do të jetë Drejtori Teknik, si vijon:
- Z./Znj. _____;
 - cel: _____;
 - e-mail: _____.



Neni 35

Dispozitat e fundit

Kontrata do të rregullohet nga/dhe interpretohet sipas Ligjeve të Republikës së Shqipërisë. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të respektohen dhe zbatohen edhe kushtet e përgjithshme e të vecanta të kontratës të dhëna në dokumentet e tenderit.

Kjo kontratë hartohet në 5 (pesë) kopje origjinale, katër për Autoritetin Kontraktor dhe një për Kontraktorin dhe pasi u lexua, firmoset rregullisht nga palët.

KONTRAKTORI

B93 II shpk

Përfaqësuar nga

Administrator

Ardit Liçaj



AUTORITETI KONTRAKTOR

Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier

Përfaqësuar nga

Drejtore

Theodhor Stefa



**OBJEKTI: MBROJTJE NGA LUMI SHUSHICE NE
DRASHOVICE, VLORE**

PROJEKT-ZBATIMI

POROSITESI: DREJTORIA E UJTJES DHE KULLIMIT FIER


GRUPI I PROJEKTIMIT: "HE & SK 11" SH.P.K





REG. NR. 141
10



2022

OBJEKTI:	MARRUTJE NGA LUMI SHUSHICE NE DRASHNOVCE, VLORE	
POROSITESI:	Drejtoria e Ujijes dhe Kulturimit Fier	
TE DHENAT MBI PROJEKTIN		
EMRI I FLETES:	HOROSGAFI	ING. INDOERTIMI
FUZA:	PROJEKT ZBATIMI	ING. HIDROTEKNIK
SHKALLA:	1:1000	ING. TOPOGRAFI
NR. FLETES:	1/01	ING. GJEOLLOG-JALEDIS
VITI:	2022	ING. HIDROTEKNIK
GRUPI I PROJEKTIMIT		
	ING. INDOERTIMI	HEKUR TI SH. P.K.
		HEMNI CELA
HE B. SK. TI		






OBJEKT:	MBRODTJE NGA LUM SHUSHICE NE DRASHOVICE,		TE DHENJA MBI PROJEKTIN		GRUPI I PROJEKTIMIT - "HESK 11" SH.P.K	
YLORE	EMRI I FLETES:	PROFILI TERHOR	ING. IDENTIMI	ARBEN BEATULLARI	ING. IDENTIMI	HENRI CELA
	FAZA:	PROJEKT-ZBATIMI	ING. HIDROTEKNIK	KUTIM BILAJ		
	SHKALLA:	1:250	ING. TOPOGRAF	LJANI BREGU		
	NR.FLETES:	T-01	ING. GJEOL. GJEOD. SAZAN GURI			
FOROSITESH:	Drejtona e Ujipes dhe Kullimit For	VITI:	2022	ING. HIDROTEKNIK	SPARTAK SHEHU	




OBJEKTI:	MBROJTJE NGA LUMI SHUSHICE NE DRASHOVICE, VLORE	TE DHENA MBI PROJEKTIN	EMRI I FLETES:	PROFILI TERHIOR	ING. ANDERTIMI	GRUPI I PROJEKTIMIT	"HEKSK 11" SH.P.K	HENRI CISA
POSITESI:	Drejtorja e Ujipes dhe Kullimit Fier	FAZA:	PROJEKT-ZBATIMI	ING. HIDROTEKNIK	ING. ANDERTIMI			
		SHKALLA:	1:250	ING. TOPOGRAFI	KLITIM BUAJ			
		NR.FLETES:	1-42	ING. GJEOLOG-JAMEDIS	LUAN BREGU			
		VITI:	2022	ING. HIDROTEKNIK	SPARTAK SHENI			







Kuota e projektit	51.47
Distanca nga aksi	-7.79
Kuota e tokës	49.19
Distanca nga aksi	-4.71
Kuota e projektit	51.47
Distanca nga aksi	0.00
Kuota e tokës	47.92
Distanca nga aksi	2.00
Kuota e projektit	47.35
Distanca nga aksi	4.00
Kuota e tokës	47.10
Distanca nga aksi	6.00
Kuota e projektit	46.90
Distanca nga aksi	8.00
Kuota e tokës	46.69
Distanca nga aksi	10.00
Kuota e projektit	46.49
Distanca nga aksi	12.00
Kuota e tokës	46.28
Distanca nga aksi	14.00
Kuota e projektit	46.08
Distanca nga aksi	16.00
Kuota e tokës	45.94



Kuota e projektit	51.40
Distanca nga aksi	-5.65
Kuota e tokës	49.19
Distanca nga aksi	-4.71
Kuota e projektit	51.40
Distanca nga aksi	0.00
Kuota e tokës	47.92
Distanca nga aksi	2.00
Kuota e projektit	47.35
Distanca nga aksi	4.00
Kuota e tokës	47.10
Distanca nga aksi	6.00
Kuota e projektit	46.90
Distanca nga aksi	8.00
Kuota e tokës	46.69
Distanca nga aksi	10.00
Kuota e projektit	46.49
Distanca nga aksi	12.00
Kuota e tokës	46.28
Distanca nga aksi	14.00
Kuota e projektit	46.08
Distanca nga aksi	16.00
Kuota e tokës	45.94



OBJEKT:	MBROJTJE NGA LUMI SHUSHICE NE DRASHOVICE,			
VLORE:	TE DHENA MBI PROJEKTIN			
PROJEKTESI:	EMRI I FLETES:	PROFILU TERRIOR	ING. IDENTIMI	ARBEN REPAJLLARI
	FAZA:	PROJEKT ZBATIMI	ING. HIJROTEMIK	KUTIM BILAJ
	SHKALLA:	1:250	ING. TOPOGRAFI	LIAN BREGU
	NR. FLETES:	T-93	ING. GJEOLLOG-MIENJIS	SAZAN GJURI
	VITI:	2022	ING. HIJROTEMIK	SPARTAK SHEHU
			GRUPI I PROJEKTIMIT	"HEASK 11" SH.P.K.
			ING. IDENTIMI	HENRI CELA







OBJEKTI:	MBRQJITJE NGA LUMI SHUSHICE NE DRASHOVICE,	TE DHENIA MBI PROJEKTIN	EMRRI I LETES:	PROFILU TERBOR	ING. NDERITIMI	ARBEN REFATLLARI	GRUPI I PROJEKTIMIT	"HERSK 11" SH.P.K.	HENRI DELA
VLORE:		FUZA:	PROJEKT ZBATIMI	ING. HIDROTEKNIK	KULTIM BILAJ	ING. NDERITIMI			
PROJEKTESI:	Drejtoria e Ujijes dhe Kulturit. Fir	SHKALLA:	1:250	ING. TOPOGRAF	LUAN BREGU				
		ING. FLETES:	1-01	ING. GJEOL. OG. ALBENI	SAZANI GURI				
		VITI:	2022	ING. HIDROTEKNIK	SPARTAK SHENU				





OBJEKTI:	MBROJTJE NGA LUMI SHUSHICE NE DRASHOVICE,	TE DHENA MBI PROJEKTIN:	ING. ANDERTINI	GRUPI PROJEKTIMIT:	"HEASK TI SH.P.K."
VLONJE:	PROJEKTU TERRITOR	EMRIT FLETES:	ING. HIDROTEKNIK	ING. ANDERTINI	HEASK TI SH.P.K.
PROJESTESI:	Drejtoria e Ujtes dhe Kullimit Flor	FAZA:	PROJEKT-ZBATIMI	ARBEN BEATILARI	HEASK TI SH.P.K.
		SHKALLA:	1:250	ING. TOPOGRAF	HEASK TI SH.P.K.
		NR.FLETES:	145	ING. GJEOLLOG-MEDIS	HEASK TI SH.P.K.
		VITI:	2022	ING. HIDROTEKNIK	HEASK TI SH.P.K.
				SPARTAK SHEHIT	HEASK TI SH.P.K.







OBJEKTI:	MIRROJTJE NGA LUMI SHUSHICE NE DRASHOVICE,			
VLORE:	VITORE			
PROJESTI:	Drejtoira e Ujtes dhe Kullimit, Fier			
TE DHENEA MBI PROJEKTIN:	EMRI I FLETES:	PROFILU TERITOR	ING. DERTIMI	GRUPI PROJEKTIMIT
FAZA:	PROJEKT-DEBTIMI	ING. HIDROTEKNIK	ARBEN BEHATLLARI	"HEBESH 11" SH.P.K
SHKALLA:	1:250	ING. TOPOGRAF	LJAN BEGU	HENR DELA
NR. FLETES:	1-07	ING. GJEDLOG-MJEDIS SAZAN GURI		
VITI:	2022	ING. HIDROTEKNIK	SPARTAK SHEHADI	



PK 15 0+269



OBJEKT:	MIRROJTJE NGA LUMI SHUSHICE NE DEASHOVICË, VILORË	
PROJESTES:	Drejtoria e ujtes dhe Kullimit Fior	
TE DHENAT MBI PROJEKTIN	EMRI I FLETES:	INGJANDERTIMI
	FAZA:	ING. HIDROTEKNIK
	SHKALLA:	ING. TOPOGRAF
	NR FLETES:	ING. GJEOLOG-MEDIS
	VITI:	ING. HIDROTEKNIK
		ARBEN RESHATILLARI
		KULTIM BILAJ
		LUAN BREGU
		SAZAN GURI
		SPARTAK SHEHU
		GRUPI PROJEKTIMIT "HESK 11" SH.P.K
		INGJANDERTIMI
		HENR OJELA



